

UDHËZUES PRAKTIK



PËR MBROJTJEN DHE SIGURINË E GAZETARËVE

Manual
me këshilla
praktike
për gazetarët
për të punuar
më të sigurt

Dhjetor 2021

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



RESPUBLICA

Autorë: Av. Dorian Matlija, Dr. Irena Dule
Botues: Qendra “Res Publica”
Shtypur nga: Expo Vision Albania
Redaktimi & kopertina: Av. Dorian Matlija
Foto e kopertinës marrë nga www.unwomen.org

Ky publikim është prodhuar në kuadër të programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019–2022” dhe projektit të tij “HF 32 - Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Shqipëri (JUFREX 2).

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasbourg Cedex ose publishing@coe.int).

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

UDHËZUES PRAKTIK

PËR MBROJTJEN
DHE SIGURINË
E GAZETARËVE

Manual
me këshilla
praktike
për gazetarët
për të punuar
më të sigurt

TREGUESI I LËNDËS

5 I. HYRJE

7 II. PSE SHËRBEN KJO BROSHURË

9 III. ÇFARË TË BËNI PARA DHE GJATË NJË SITUATE KËRCËNUESE

9 1. Cfarë të bëni në rastet e përballjes me policinë?

17 2. Si të mbrosh burimet konfidenciale?

23 3. Si të rrisni sigurinë në internet?

26 4. Si të shmangni rreziqet, kur raportohet mbi protestat/demonstratat

36 5. Si të ruheni nga përgjimi

36 6. Si të mbroheni nga ndjekja/mbikqyrja?

39 IV. ÇFARË TË BËNI PAS NJË SITUATE KËRCËNUESE

39 1. Çfarë të bësh kur ndihesh i kërcënuar?

39 2. Te cilat organizata të drejtohesh për të kërkuar ndihmë?

40 3. Çfarë të bësh kur goditesh për shkak të detyrës?

42 4. Si të veprosh për tu mbrojtur nga kallëzimet/paditë e bëra nga zyrtarët (Paditë SLAPP)?

49 5. Si të veprosh kur të rrezikohen burimet nga sekuestrimi i pajisjeve?

51 V. KËSHILLA TË TJERA TË PËRGJITHSHME

51 1. Rrisni sigurinë mes rritjes së profesionalizmit

52 2. Raportimi i kronikës së zezë

55 3. Këshilla për gazetarët që mbulojnë Covid-19

I. HYRJE

Kjo broshurë është përgatitur nga qendra Res Publica, në kuadër të projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për “Lirinë e shprehjes dhe lirinë e media në Shqipëri (JUFREX 2).

Ajo vjen në kontekstin e një pune të zgjeruar të qendrës Res Publica për mbrojtjen e gazetarëve dhe lirisë së shprehjes e të drejtës së informimit dhe synon të sjellë një doracak udhëzues për gazetarët për të punuar më të sigurt dhe për të parandaluar ose zgjidhur konfliktet.

Liria e shprehjes nuk mund të realizohet nëse gazetarët punojnë në kushte të ndikimit nga korrupsioni, varfëria ose frika, prandaj sigurimi i mjedisit të sigurt për punën e gazetarëve është domosdoshmëri në një shoqëri demokratike. Në një klimë ku gazetarët punojnë pa frikë, ata kanë aftësinë të sjellin informacion jetik para publikut, qytetarët e kanë më të lehtë për të aksesuar informacion cilësor që çon si rezultat në një qeverisje më demokratike, mbrojtje më të madhe të të drejtave të njeriut, mbrojtje më të mirë të mjedisit, etj.

Siguria e tyre është e cenueshme nga intimidimi, deri te kërcënimet për ndjekje penale, arrestime, ndalime nga policia, çdo lloj forme burgimi,

mohimi i aksesit të gazetarëve në informacion, paditë SLAPP, sulme ndaj mjeteve me të cilat gazetarët ruajnë burimet, hetime administrative, si për shembull nga autoritetet tatimore, etj.

Interneti ka sjellë një efekt transformues, duke zgjeruar hapësirat e komunikimit jo vetëm për gazetarët profesionistë por edhe për komunitetin, gazetarët qytetarë, blogerët dhe përdorues të tjerë. Megjithatë, ndërsa është rritur pluralizmi i raportimit, përdoruesit e internetit janë bërë gjithnjë e më shumë objektiv i dhunës.

Kjo broshurë është bërë pas një hulumtimi mbi rreziqet dhe kërcënimet reale me të cilat përballen gazetarët dhe punonjësit e mediave jo vetëm në kontekstin shqiptar, por edhe më gjerë.

II. PSE SHËRBEN KJO BROSHURË?

Kujt i drejtohen këto këshilla?

Kjo broshurë iu drejtohet jo vetëm gazetarëve të njohur “zyrtarisht” si të tillë, por të gjithë punonjësve të medias, qofshin ato profesionale, apo media e komunitetit, gazetarëve qytetarë dhe të tjerë që mund të përdorin media të reja si një mjet për të arritur audiencën e vet.

Kur nevojitet siguria e gazetarëve?

Siguria e gazetarëve nevojitet gjatë gjithë kohës. Ajo rritet ndjeshëm nëse ndiqen këshillat se si të shmangë sa më shumë situatat kërcënuese, apo ato që vijnë pas një situatë kërcënuese.

Veprimet parandaluese janë të domosdoshme, njësoj si ato gjatë një situatë kërcënuese, të cilat mund të ulin rreziqet dhe dëmet.

Kush mund të sulmojë gazetarin?

Mbrojtja e gazetarëve duhet të përshtatet me realitetet lokale. Gazetarët që raportojnë për korrupsionin dhe krimin e organizuar, për shembull, janë gjithnjë e më shumë në shënjestër nga grupet e krimit të organizuar dhe pushtetet paralele.

Sulmuesit e zakonshëm të një gazetari janë:

- Krimi i Organizuar;
- Qeveritë e korruptuara;
- Punonjësit e policisë;
- Biznesmenët që ushtrojnë praktika të paligjshme;
- Individë ose grupime të keqindoktrinuara.

Cilat janë situatat më të zakonshme që prekin sigurinë e gazetarit?

- Goditja për shkak të detyrës;
- Abuzimi verbal;
- Paditë, akuzat për shpifje/fyerje;
- Ndalimi/kontrollet nga organet e Policisë/Prokurorisë;
- Aludime për telashe që mund të vijnë, si pasojë e ofrimit të ryshfetit, etj.;
- Cenim i burimeve të gazetarit;
- Kanosje për dhunë, përdhunim;
- Sulme kibernetike.

Kjo më sipër nuk është një listë gjithëpërfshirëse.

III. ÇFARË TË BËNI PARA DHE GJATË NJË SITUATE KËRCËNUESE?

1. Cfarë të bëni në rastet e përballjes me policinë?

Eksperienca tregon se punonjësit e policisë janë më të vetkontrolluar kur përballen me një person që i njih të drejtat e veta, ndaj këshillat lidhen me mënyrën si sillësh gjatë procesit.

Këshillë praktike paraprake: Mos e “bërtit” fort që i njih të drejtat e tua. Demonstroje me veprime dhe sjellje që i njih të drejtat e tua.

a. Cfarë të bëni kur policia ju vjen në derë?

- Të keni gjithmonë në listën e numrave të shpejtë në telefon një avokat për ta thirrur në rast urgjence dhe mundësisht mësojeni përmendësh numrin e tij. Kjo është e rëndësishme, pasi mund të ndodhë që telefoni juaj të sekuestrohet dhe duhet të bëni një telefonatë nga një telefon tjetër.
- Mësoni përmendësh numrat e telefonit të kryeredaktorit tuaj dhe të çdo personi tjetër të rëndësishëm që mund t'i telefononi për t'i njoftuar se ku jeni dhe çfarë po ndodh.
- Mundohuni të qetësoheni dhe telefononi menjëherë avokatin tuaj. Mund të mundësinë e një telefonate të vetme.

- Mos nxitoni të hapni derën menjëherë. Kërkojuni punonjësve të policisë të tregojnë dokumentin e identifikimit të policisë dhe urdhrin e kontrollit. Këtë veprim mund ta kryeni përmes syrit magjik, ose duke hapur derën aq sa lejon shuli apo zinxhiri i derës. Nëse nuk keni instaluar një të tillë, merrni masa ta vendosni. Ndërsa ata kryejnë veprimet e kërkuara nga ana juaj, ju keni kohë të kontaktoni avokatin ose kryeredaktorin tuaj dhe të përpiqeni të qetësoheni.
- Vendosni telefonin në xhep. Në këtë mënyrë bëhet zyrtarisht një pronë personale, kështu që për ta sekuestruar, punonjësit të policisë do t'i duhet një urdher tjetër për një kontroll personal.
- Nëse oficeri i policisë ju kufizon të komunikoni me njerëz të tjerë (merrni një përgjigje specifike “Po” ose “Jo” nëse mund ta bëni këtë) dhe deklaroni: “Nëse doni të më merrni telefonin, duhet të bëni një kontroll personal”. Kontrolli personal duhet të kryhet nga një oficer i së njëjtës gjini.
- Jini të kujdesshëm për sigurinë e llogarive tuaja, por mos e komplikoni shumë sistemin tuaj të fjalëkalimeve: Duhet të keni akses në disa shërbime në internet edhe nëse të gjitha pajisjet tuaja janë sekuestruar.
- Bëni një fotografi ose një kopje me shkrim të urdhrin të kontrollit, nëse ju lejojnë.
- Kërkoni arsyet e kontrollit nga policia dhe Vendimin e Gjykatës për kontroll.
- Vendimi për lejimin e kontrollit duhet të tregojë llojin e kontrollit, personin që kontrollon dhe gjeneralitetet e tij, vendin apo banesën objekt kontrolli, provat

materiale apo sendet që kërkohen, arsyet që lejojnë kontrollin, si edhe autoritetin që do të kryejë atë. Nëse në pajisjet telefonike apo kompiuterike keni të dhëna që mund të tregojnë burimet, mund të rezistoni së dhëni pajisjet, ose kodet e hapjes së tyre.

- Punonjësit e Policisë duhet të deklarojnë atë që kërkojnë. Nëse ata nuk përgjigjen pas disa kërkesave, kjo vlen të përmendet në çdo procesverbal. Mbani mend që keni të drejtë të bëni shënime në procesverbal.
- Nëse ata fillojnë të godasin apo thyejnë derën tuaj, kjo mund të jetë një veprim i rregullt, por gjithsesi kjo tregon se oficerët kanë qëllim të veprojnë ashpër.
- Ju keni të drejtën të kërkoni prezencën e një personi të besuar (dëshmitar) të jetë i pranishëm gjatë kontrollit.
- Kërkojini personit të besuar t'i kushtojë vëmendje aktiviteteve të policisë dhe të ndjekin çdo hap të oficerëve.
- Ju keni të drejtën të kërkoni shtyrjen e kontrollit deri në dy orë nga momenti që njoftoni avokatin, nëse dëshironi që kontrolli të bëhet në prezencën e një avokati.
- Sigurohuni që të flisni me oficerët e policisë. Shpjegoni se jeni gazetar dhe supozoni se kontrolli është i lidhur me punën tuaj. Kërkojuni dëshmitarit t'i kushtojë vëmendje veprimeve të policisë dhe të ndjekë çdo hap të tyre.
- Këmbëngulni për një kontroll të njëpasnjëshëm (dhome pas dhome dhe jo për t'u shpërndarë nëpër apartament sipas dëshirës) dhe praninë e dëshmitarëve për të

dëshmuar në çdo hap. Nëse kjo nuk ndiqet, duhet ta shënoni këtë në procesverbal.

- Kini parasysh që kontrolli në një banesë nuk mund të kryhet nga ora 20.00 deri në 07.00, përveçse në raste të ngutshme. Në këto raste kërkoni vendimin me shkrim.
- Mos harroni që policia duhet të presë deri në 2 orë për të ardhur avokati juaj. Kërkoni që deri në atë moment të mos kryhet asnjë veprim. Nëse kjo kërkesë nuk merret parasysh, shënojeni këtë në procesverbal.
- Mos harroni se nëse jetoni me një person tjetër, pajisjet, dokumentet dhe sendet e bashkëshortit ose të afërmit tuaj mund të sekuestrohen gjithashtu dhe kjo mund të konsiderohet e ligjshme.

b. Çfarë dokumentash duhet t’ju paraqesin përpara dhe pasi t’ju kontrollojnë shtëpinë?

Prokurori/oficeri i policisë duhet t’ju paraqesë vendimin për kontroll dhe procesverbalin e kontrollit - një procesverbal të asaj që ka ndodhur. Lexojeni me vëmendje. Ai duhet të deklarojë:

- Datën, orën kur filloi dhe mbaroi kontrolli.
- Adresat (duke përfshirë adresat e dëshmitarëve).
- Emrat e plotë dhe nënshkrimet e pjesëmarrësit në kontroll (grupi hetimor, operativët, dëshmitarët, etj.).
- Nëse diçka është shkruar në mënyrë të palexueshme (me shkrim të keq, etj.), kërkoni që të shtypet ose të rishkruhet mirë.

- Të gjitha fushat bosh në formularin e procesverbalit duhet të plotësohen (përdorni vijëzimin e të gjithë fushës bosh, që ngjan me simbolin Z), në mënyrë që asgjë të mos plotësohet më vonë.
- Formulari i procesverbalit përmban një seksion “Vërejtje”. Nëse thotë “pa vërejtje”, verini kryq asaj dhe shkruani vërejtjet tuaja. Nëse nuk ka hapësirë të mjaftueshme, përmendni: “Vërejtjet e shtuara janë në fletë shtesë” dhe tregoni sasinë e faqeve shtesë.
- Ju duhet të merrni një kopje të procesverbalit. Kopja duhet të jetë e njëjtë me origjinalin. Nëse kopjes i mungon diçka (nënshkrime ose vërejtje), atëherë shkruani në formularin e marrjes së kopjes: “Kopja e procesverbalit nuk u mor”.

c. Cilat janë vërejtjet dhe si t’i shkruani ato?

- Vërejtjet tuaja duhet të përmendin të gjitha pikat kur të drejtat tuaja janë shkelur ose keni arsye të supozoni se janë shkelur. Më vonë, në bazë të vërejtjeve tuaja, ju mund të bëni një ankesë për veprimet e oficerëve. Kjo do të shtojë dokumente në dosjen e hetimit dhe do të shtojë dokumente për shqyrtim për gjyqtarët.
- Të gjitha vërejtjet tuaja ndihmojnë në krijimin e një “gjurme në letër”. Mendojini ato si fjetet e një rrjete sigurie për ju dhe avokatët që do të mbrojnë të drejtat tuaja. Vërejtjet mund të përmendin çdo gjë, si për shembull: “Kërkimi zgjati nga ... në ... dhe unë nuk mora ushqim dhe ujë. Nuk

u prezantuan ID-të. Ngrita shqetësimet e mëposhtme lidhur me dëshmitarin (personin e besuar), por kërkesa nuk u plotësua, kërkoja të mos sekuestrohej pasjisa sepse rrezikohen burimet, por kërkesa nuk u mor parasysh”, etj.

d. Cfarë të bëni nëse ju kërkojnë të paraqiteni për të dëshmuar para organeve të akuzës?

- Nëse oficerët ju ftojnë privatisht në telefon, për një seancë pyetjesh në komisariat/drejtorinë e policisë, refuzoni, duke u thënë atyre se jeni në pritje të një thirrje zyrtare.
- Nëse ata kërcënojnë se do t’ju marrin me forcë, është më mirë që të pajtoheni dhe të shkoni në komisariat. Përndryshe, ata mund t’ju vënë pranga dhe ju do të ndaloheshit me një akuzë zyrtare, e cila pavarësisht se mund të jetë e paligjshme, do dojë kohë që të sqarohet dhe ndalimi në këto kushte nuk është i dëshirueshëm. Megjithatë, kujtoni që kjo është një shkelje! Ju duhet ta përmendni këtë në vërejtjet tuaja në procesverbal.
- Nëse ata përdorin forcë kundër jush – mos rezistoni. Në të kundërt rrezikoni të shkelni dispozitat e Kodit Penal – kundërshtimi i punonjësit të policisë, edhe sikur rezistenca të jetë pa dhunë.
- Nëse pyeteni si person i paraburgosur, rregulli kryesor është të mos flisni pa avokatin tuaj. Përgjigjuni të gjitha pyetjeve me të drejtën për të heshtur. Mos pranoni lehtësisht avokatin e ndihmës juridike falas! Shpesh këta avokatë zgjidhen nga prokurori për të legjitimuar procedurën e tyre dhe

pagesa e tyre është tepër e ulët për t'ju ofruar një shërbim avokator cilësor.

- Ata duhet t'ju japin mundësinë e një telefonate. Nëse ata nuk e bëjnë, përmendeni këtë në vërejtjet tuaja.
- Nëse keni një sëmundje dhe keni nevojë për mjekim të veçantë, përmendeni në procesverbal dhe kërkoni që t'ju ofrojnë barnat që ju nevojiten. Nëse nuk e bëjnë, përmendeni te vërejtjet në procesverbal.
- Pas pyetjeve ata duhet t'ju japin një kopje të procesverbalit. Parimi është si vijon: lexoni me kujdes, kryqëzoni hapësirat boshe (Z) dhe shprehni të gjitha vërejtjet tuaja në fushën përkatëse. Ata duhet të lëshojnë menjëherë një kopje të procesverbalit për ju. Nëse thonë se do ta japin më vonë, kërkoni menjëherë. Mos nënshkruani njëren kopje pa qenë kopja tjetër gati, e qartë në shkrim dhe e njëjtë në përmbajtje. Shënoni këtë vërejtje në kopjen e parë.

e. Çfarë duhet të bëni nëse gjendeni përpara një tentative të kontrollit personal?

- Kontrolli personal në rrugë apo kudo nuk mund të bëhet pa iu dorëzuar një kopje e vendimit të kontrollit, duke jua bërë të ditur të drejtën për të kërkuar praninë e një personi të besuar, me kusht që ai të gjendet shpejt dhe të jetë i përshtatshëm.
- Kontrolli bëhet duke respektuar dinjitetin dhe integritetin personal të atij që kontrollohet.
- Kontrolli i personit bëhet nga një person i së njëjtës gjini, me përjashtim të rasteve

kur kjo nuk është e mundur për shkak të rrethanave. Mbani mend që rrethana të tilla mund të jenë shumë të rralla dhe mos hezitoni të insistoni në kërkesën tuaj.

f. Çfarë duhet të bëni nëse gjendeni përpara ndalimit në rrugë?

- Oficerët e policisë gjatë një kontrolli duhet të prezantohen. Nëse afrohen dhe thonë: “Ejani me ne, kemi disa pyetje”, ju duhet të pyesni menjëherë: “A jam i ndaluar?” Nëse ata thonë se thjesht duan t’ju identifikojnë, ju mund të tregoni ID-në tuaj në vend dhe nuk keni pse të shkoni askund.
- Nëse gjithsesi ju ndalojnë, ata duhet të plotësojnë procesverbalin e ndalimit. Sapo të ndaloheni, mund të kërkonti të drejtën tuaj për një telefonatë. Sigurohuni që gjithçka të shënohet në procesverbal, në të cilin mund të shtoni vërejtje. Nëse ata kryejnë thjesht një kontroll personal duhet të lëshohet gjithashtu një procesverbal.
- Oficerët janë të detyruar të shpjegojnë arsyet e ndalimit tuaj.
- Nëse ju japin një arsye dhe më pas përpiqen t’ju akuzojnë për një arsye tjetër, ky është mashtrim. Përmendeni këtë në procesverbal dhe më pas bëni ankesë për ndalim të paligjshëm.
- Memorizoni nëse ka kamera jashtë ose dëshmitarë të tjerë, si kalimtarë. Kjo mund të jetë e nevojshme për deklaratat e dëshmitarëve në lidhje me ndalimin tuaj më vonë.
- Një rregull tjetër i rëndësishëm: Mos rezistoni me veprime, mos u sillni ashpër

dhe mos mbani përgjues me vete. Nëse e keni një të tillë me vete për shkak të punës, mos u ngutni ta aktivizoni hapur, si formë presioni ndaj oficerëve. Mundohuni të jeni të sjellshëm kur është e mundur.

2. Si të mbrosh burimet konfidenciale?

Mbrojtja e burimeve konfidenciale është një gur themeli i raportimit etik. Kur gazetarët kanë rënë dakord të mbrojnë identitetin e dikujt, ata duhet të bëjnë çdo përpjekje për ta bërë këtë, veçanërisht në rrethanat kur një burim mund të arrestohet ose dëmtohet.

Ruajtja e konfidencialitetit është bërë më sfiduese për shkak të rritjes së niveleve të mbikëqyrjes dhe monitorimit dixhital nga autoritetet dhe publiku. Prandaj, gazetarët duhet të marrin parasysh këshillat e mëposhtme të sigurisë për të ndihmuar në mbrojtjen e identitetit të burimeve konfidenciale.

a. Si të identifikoni dhe mbronni burimet konfidenciale?

- Është jashtëzakonisht e rëndësishme përgatitja juaj përpara se të angazhoheni me burime konfidenciale, në mënyrë që të siguronit një bashkëpunim të vazhdueshëm, komunikim të sigurt dhe marrëdhënie besimi.
- Asnjëherë mos supozoni se një burim është i gatshëm t'i përmendet emri. Kërkoni gjithmonë pëlqimin. Mbani mend që personi që përgjohet nga ju në një bisedë pa dijeninë ose pëlqimin e tij, nuk konsiderohet burim!

- Hulumtoni çdo detyrim ligjor në lidhje me punën me burime konfidenciale.
- Përpiquni të zbuloni nëse burimi ka folur më parë me gazetarë të tjerë, ose nëse organizata të tjera mund të përpiqen ta kontaktojnë.
- A ka rrezik që burimi të jetë nën vëzhgim? Nëse autoritetet ose grupe të caktuara e kanë tashmë në radarin e tyre, angazhimi me ta mund t'ju vërë në rrezik.
- Caktoni një metodë verifikimi të tillë si një frazë e pazakontë ose një pyetje për t'iu përgjigjur, dhe përdorni atë sa herë që flisni me burimin.
- Në varësi të rrezikut, mund t'ju duhet të identifikoni një vend ku mund të zhvendoseni përkohësisht për arsye sigurie.
- Përdorimi i informacionit të klasifikuar ose të vjedhur mund të ketë pasoja serioze për ju, si dhe për organizatën tuaj mediatike.
- Sa i dobishëm dhe i besueshëm është informacioni i tyre? Merrni parasysh motivimin e tyre dhe nëse ata mund të paraqesin rrezik për ju ose organizatën tuaj.
- Si mund të rrisësh sigurinë dixhitale? Ka një sërë mënyrash sesi mund të aksesohen të dhënat, duke përfshirë përgjimet nga institucionet ligjzbatuese, ato të qeverisë, aksesin fizik në pajisjet tuaja elektronike, si telefoni apo kompjuteri personal, hakerimin dhe softuerë spiunë të llojeve të ndryshme.
- Kur është e mundur, mos përdorni pajisjet tuaja personale ose të punës për të kontaktuar burime sensitivë.

- Blini pajisje të tjera posaçërisht për të komunikuar me ta dhe mbani të ndara të dhënat tuaja të punës dhe personale.
- Aktivizoni autentifikimin me dy faktorë për të gjitha llogaritë dhe përdorni fjalëkalime të gjata unike.
- Përditësoni rregullisht pajisjet, aplikacionet dhe shfletuesit tuaj në versionin më të fundit për t'u mbrojtur më mirë nga aplikacioni malware dhe spyware.
- Bëjeni burimin të vetëdijshëm për praktikatat më të mira dixhitale dhe rreziqet e përfshira, në mënyrë që ata të mund t'ju kontaktojnë në mënyrën më të sigurt të mundshme.
- Kufizoni sa më shumë kontaktin me burimin.
- Kini parasysh se kompanitë e telefonisë celulare dhe ofruesit e shërbimeve të internetit mbledhin të dhëna për përdoruesit e tyre, duke përfshirë të dhëna që mund të përdoren për të identifikuar dhe gjetur ju dhe kontaktet tuaja.
- Mesazhet SMS dhe telefonatat fikse ose celulare të bëra nëpërmjet një kompanie telekomunikacioni, nuk janë të koduara që do të thotë se qeveritë dhe të tjerët mund të kenë akses në informacion.
- Telefoni juaj celular mund të përdoret për të gjetur ju dhe burimin tuaj. Nëse takoheni personalisht, të dy duhet të mos i keni telefonat tuaj personalë me vete.
- Komunikoni me burimet duke përdorur aplikacione mesazhesh të koduara nga skaji në skaj, kur është e mundur, të tilla si

Signal, WhatsApp ose Wire. Kur përdorni Signal dhe WhatsApp, aktivizoni mesazhet që zhduken. Këto shërbime kanë dallime të rëndësishme kur bëhet fjalë për sigurinë.

- Nëse një burim ju kontakton nëpërmjet një shërbimi që nuk është i koduar nga skaji në skaj, zhvendoseni bisedën në një shërbim të koduar sa më shpejt të jetë e mundur. Aty ku është e mundur, fshini mesazhin origjinal dhe inkurajoni burimin tuaj të bëjë të njëjtën gjë. Kjo do të fshijë vetëm mesazhin nga llogaria, një kopje ka të ngjarë të ekzistojë ende në serverin e kompanisë.
- Nëse keni nevojë të kontaktoni burimin tuaj me email, konfiguroni një llogari të re emaili për ta përdorur vetëm për këtë qëllim.
- Llogaria nuk duhet të përmbajë asnjë të dhënë personale si emri juaj i vërtetë dhe nuk duhet të lidhet me numrin tuaj të telefonit ose ndonjë llogari në internet në emrin tuaj. Lexoni më shumë se si të krijoni një llogari emaili në udhëzuesin e sigurisë dixhitale të Rory Peck Trust.

b. Si të mbani në administrim dokumente sensitive

- Kini parasysh se pothuajse çdo gjë që bëni në pajisjet tuaja ka të ngjarë të lërë gjurmë edhe pasi ta keni fshirë atë. Ekspertët IT mund të rikuperojnë përmbajtjen e fshirë edhe nëse keni përdorur softuer të specializuar për të pastruar kompjuterin tuaj.
- Mbani dokumente sensitive në një kompjuter i cili është modifikuar në

mënyrë që të mos jetë në gjendje të lidhet me internetin. Kjo zvogëlon mundësinë që dikush të mund t'i aksesojë.

- Për çështje shumë të ndjeshme, merrni parasysh përdorimin e Tails, një sistem operativ portativ i sigurt për përdorim në çdo kompjuter.
- Dërgoni dokumente sensitivë përmes SecureDrop duke përdorur shfletuesin TOR nëse redaksia ose organizata juaj e ka të konfiguruar. Do t'ju duhet një specialist i sigurisë dixhitale për t'ju ndihmuar me këtë.
- Dokumente nën 100 MB komunikojini nëpërmjet Signal ose një shërbimi tjetër të koduar nga skaji në skaj. Dokumentet mbi 100 MB mund të dërgohen duke përdorur OnionShare.
- Kini parasysh se të dhënat meta të mbajtura në dokumente, si skedarë dhe aplikacione të mesazheve – si koha dhe data e dërgimit të një dokumenti – nuk janë gjithmonë të koduara dhe mund të ndihmojnë dikë të identifikojë burimin tuaj.
- Kini një proces për rezervimin dhe fshirjen e përmbajtjes së ruajtur në aplikacionet e mesazheve. Flisni me burimin tuaj se si mund të menaxhojë më mirë të dhënat e ruajtura në aplikacionet dhe në pajisjet e tij. Konsultohuni me një profesionist të sigurisë dixhitale për mënyrën më të mirë për të menaxhuar këto të dhëna.
- Rishikoni rregullisht pajisjet për dokumente dhe të dhëna që mund t'ju rrezikojnë ju ose të tjerët, veçanërisht nëse jeni duke kaluar kufijtë ose pikat e kontrollit.

- Kriptoni pajisjet, dokumentet dhe disqet e jashtme ku është e mundur dhe sigurohuni që fjalëkalimi juaj i enkriptimit të jetë i gjatë dhe unik. Jini të vetëdijshëm për ligjet rreth kriptimit në vendet ku jetoni, punoni dhe udhëtoni. Mund t'ju kërkohet të zhbllokoni pajisjet e koduara. Nëse e bëni këtë apo jo është një zgjedhje personale.

c. Si të planifikoni takimet me burimet?

- Vlerësoni avantazhet dhe disavantazhet e takimit personal kundrejt komunikimit nëpërmjet një platforme të sigurt dixhitale.
- Vendosni se kush është përgjegjës për mbledhjen dhe kush është përgjegjës për ndryshimin e planeve të ditës.
- Takohuni në një vend neutral që nuk mund të lidhet me adresën e shtëpisë ose të punës së burimit tuaj. Sigurohuni që të ketë rrugë të shumta daljeje.
- Monitoroni për çdo shenjë vëzhgimi gjatë takimit. Kini pranë një kontakt të besuar për të ngritur alarmin nëse është e nevojshme.
- Përcaktoni se si do të transportoni në mënyrë të sigurt informacionin e ndjeshëm nga takimi në vendin tuaj të punës, veçanërisht nëse mund të ndihmojë dikë tjetër të identifikojë burimin.
- Merrni parasysh opsionet e transportit. Nëse përdorni transport publik, paguani me para në dorë në vend që të përdorni një kartë bankare, e cila mund të gjurmohet.
- Tërhiqni para të paktën një ditë para takimit për të ulur mundësinë që çdo pamje nga ATM të përputhet me ditën e takimit.

- Targat e regjistrimit të automjeteve private mund të gjurmohen nga kamerat. Përpiquni të parkoni automjetin jashtë syve në një zonë të sigurt dhe gjithmonë parkoni përballë drejtimit të ikjes. Nëse dyshoni se jeni duke u mbikqyrur, kthehuni dhe anuloni takimin.

3. Si të rrisni sigurinë në internet?

Të qenit aktiv në internet dhe përmes mediave sociale është një pjesë e madhe e punës së çdo gazetari. Aktiviteti në internet bëhet jo vetëm për të promovuar punën tuaj, për të gjetur burime dhe për të qenë pjesë e bisedës, por edhe për të dëgjuar lexuesit tuaj dhe për t'u angazhuar me ta. Megjithatë, mund t'ju ekspozojë edhe ndaj abuzimeve verbale dhe kërcënimeve.

Është e rëndësishme të keni një fjalëkalim të sigurt, duke mundësuar autentifikimin me dy hapa në llogaritë tuaja dhe përdorimin e kriptimit për komunikimet më sensitive. Megjithatë kujtoni që kaq nuk mjafton.

a. Ju jeni kontrolluesi i prezantimit tuaj në internet

- Nëse kërkoni emrin tuaj në Google, a e dini saktësisht se çfarë do të shfaqet për ju në faqen e parë të rezultateve? Për shumicën e gazetarëve do të jetë një përzierje e mediave sociale dhe linqeve, por nëse i lini këto rezultate rastësisë (ose rastësisë së një algoritmi), një person keqdashës mund ta kthejë atë faqe në një koleksion lidhjesh që cenojnë reputacionin tuaj ose kritikojnë punën tuaj.

- Filloni të menaxhoni emrin dhe reputacionin tuaj në internet sa më shpejt që të mundeni.
- Blerja e një domeni në internet me emrin tuaj dhe krijimi i një portofoli me emrin tuaj në çdo format ndihmon algoritmet e Google të lidhin emrin tuaj me punën tuaj. Nëse lidhni artikujt tuaj në faqe të tjera, kjo e përforcon atë lidhje dhe e bën më të vështirë për dikë që të shfaqë përmbajtje të dëmshme.

b. Zhvilloni një rrjet

- Reputacioni ndërtohet përmes fjalëve të të tjerëve. Dhe nëse të tjerët ju njohin ju dhe punën tuaj, mund të ketë një efekt të shumëfishtë.
- Jo vetëm që ata do të promovojnë dhe legjitimojnë punën tuaj, por, nëse jeni duke u kërcënuar ose dikush po përpiqet të përhapë thashetheme të rreme për ju, të keni një rrjet të besuarish mund të shërbejë si mburojë për ju. Ata që ju njohin do të mbrojnë karakterin dhe integritetin tuaj, duke përforcuar besueshmërinë tuaj.
- Filloni me redaksinë tuaj.
- Ndiqni kolegët tuaj në mediat sociale dhe njihuni me redaktorë, producentë dhe të tjerë jashtë rrethit tuaj të njohjeve. Bashkohuni me organizatat tregtare, merrni pjesë në konferenca dhe ndërveproni me njerëz, punën e të cilëve ju admironi. Gjithashtu, nuk dëmton asnjëherë zhvillimi i kontakteve brenda komunitetit të sigurisë në internet. Ata do të ishin aleatë të vlefshëm në rast të një sulmi.

c. Ndërtoni një mur midis jetës tuaj reale dhe jetës tuaj në internet

Reporteri Luke O'Brien shkroi një histori duke ekspozuar një llogari islamofobike në Twitter të ndjekur nga Sean Hannity, Sarah Huckabee Sanders dhe të ripostuar nga ish-Presidenti Donald Trump. Menjëherë pas këtij veprimi, ai filloi të merrte kërcënime me vdekje përmes Twitter dhe telefonata kërcënuese pasi adresa dhe informacioni i tij personal, si dhe informacioni i familjes dhe miqve të tij u postuan në internet.

Kjo praktikë, e njohur si “doxxing” është bërë një taktikë e zakonshme për të frikësuar gazetarët, aktivistët dhe këdo që tërheq zemërimin e grupeve. Gjetja dhe postimi i informacionit personal të dikujt nuk kërkon shumë aftësi teknike. Thjesht duhet të dini se ku të shikoni. Lajmi i mirë është se mund të ndërmerri hapa për të pastruar të dhënat personale si adresa juaj fizike, numri i telefonit dhe marrëdhëniet familjare nga Interneti, duke e bërë më të vështirë për doxxers gjetjen e informacionit tuaj.

Mos përmendja asnjëherë e lagjes së shtëpisë tuaj në artikujt që shkruani, mund të kenë një ndikim të madh.

Kontrollimi i llogarive tuaja të mediave sociale për t'u siguruar që asnjë nga fotot tuaja nuk shfaq pjesën e përparme të shtëpisë tuaj, emrin e rrugës tuaj ose një faturë në sfond ku njerëzit mund të lexojnë adresën tuaj.

Pastroni nga faqja juaj në rrjetet sociale çdo të dhënë personale po kështu edhe listën e bashkëpunëtorëve tuaj.

d. Jini të vetëdijshëm se si ndërveproni me të tjerët në internet

- Përfshirja në rrjetet sociale është një pjesë jetike dhe e pashmangshme e punës së një gazetari, por kjo nuk do të thotë që ju duhet t'i përgjigjeni çdo postimi ose të qendroni të heshtur kur një lexues bën një koment të papërshtatshëm ose kërcënues.
- Të mësosh të identifikosh qëllimet pas komenteve të një lexuesi dhe të dish se kur të shkëputesh është një aftësi jetike, veçanërisht për gratë, të cilat shpesh marrin më shumë abuzime për mënyrën se si duken dhe çfarë thonë.
- Megjithatë, jo të gjitha reagimet janë aq të dukshme. Disa mund të jenë një pretekst për të fituar akses në informacionin tuaj. Ju mund të merrni mesazhe që një burim dëshiron t'ju dërgojë një skedar ose një organizatë që dëshiron t'ju dërgojë në një konferencë të paguar me të gjitha shpenzimet përfshirë edhe biletën e avionit. Këto mesazhe duhen parë me kujdes për të kuptuar nëse ato janë të vërtetë apo janë një përpjekje delikate për të siguruar të dhënat tuaja.

4. Si të shmangni rreziqet, kur raportohet mbi protestat/demonstratat

Megjithëse pjesëmarrja në protesta si gazetar është e drejta juaj dhe mund të keni çdo qëllim për t'i mbajtur gjërat paqësore, është e rëndësishme të dini se çfarë të bëni nëse paraqiten rreziqe. Mbrojtja e vetes dhe e të tjerëve duhet të jetë gjithmonë prioriteti juaj kryesor, dhe përgatitja është padyshim mënyra më e mirë për të filluar.

a. Përgatitja për mbulimin e protestës

- Planifikoni mbulimin e ngjarjes para se të jeni prezent në protestë. Shikoni mundësinë për të gjetur një mënyrë më të sigurt për të marrë informacionin ose imazhet e nevojshme. Planifikoni se çfarë do të bëni nëse ju sulmojnë, ndalojnë ose ju grabisin. Nëse e dini rrugën e protestës, parashikoni rrugët tuaja të largimit dhe caktojini ato paraprakisht me anëtarët e ekipit tuaj.
- Njihni kontekstin social dhe politik që i motivon pjesëmarrësit: cilat fakte të fundit i paraprinë protestës, cili është qendrimi i përgjithshëm ndaj mediave, çfarë mendojnë ata për fushën ku punoni; a keni ndonjë karakteristikë që mund të gjenerojë rreziqe shtesë (si p.sh. të qenit grua në një kontekst që përfshin rrezikun e dhunës me natyrë seksuale); a ka grupe me histori dhune ndaj gazetarëve?
- Përpara se të niseni për në vendngjarje, kontrolloni terrenin ku do të zhvillohet protesta, identifikoni komisaritet më të afërta, vendet ku mund të strehoheni, rrugët e largimit emergjent, vendndodhjet e ngritura për të marrë pamje të mira, rrugët pa krye, bllokadat e rrugëve, spitalet dhe pikat e referimit për riorganizim në rast se ndaheni nga ekipi.
- Llogarisni sa kohë do ju duhet ju dhe ekipit tuaj që të jeni në vendndodhje për të marrë atë që ju nevojitet.
- Mbani një linjë të vazhdueshme komunikimi të hapur me redaksinë. Vendosni intervale periodike për dërgimin e mesazheve me tekst të paracaktuar dhe të koduara nëse është e nevojshme.

- Regjistroni më shumë se një numër me telefonim direkt në telefonin tuaj për raste urgjente. Futni shkronjën “A” në fillim të këtyre kontakteve, në mënyrë që ato të shfaqen në krye të listës së kontakteve. Merrni një karikues portativ me bateri për telefonin celular. Ulni ndriçimin e ekranit dhe çaktivizoni aplikacionet e panevojshme që konsumojnë energji.
- Një reporter ose asistent duhet të ndihmojë fotoreporterët dhe operatorët e kamerave, pasi ata do të jenë të fokusuar në punën e tyre për mbledhjen e imazheve. Një nga ekipi duhet të mbajë një pamje të gjerë të të gjithë skenës, gjatë gjithë kohës dhe të shqetësohet për sigurinë e ekipit. Caktojini këto role paraprakisht.
- Nëse keni një shofer, kontrolloni që ai është i njohur me vendndodhjen, është në gjendje të planifikojë rrugët e largimit emergjent, është gjithmonë në komunikim dhe nuk e lë makinën të bllokuar në vende parkimi të paarritshme.
- Nëse keni astmë, probleme të frymëmarrjes ose infeksione, jeni shtatzënë, keni imunitet të ulur, infeksion të syve ose përdorni lente kontakti dhe nuk keni syze, shmangni përfshirjen në mbulim të këtij lloji. Sigurohuni që jeni fizikisht të aftë për të kryer detyrën:
- A mund të vraponi? Mundsësisht lidhini pajisjet e domosdoshme me rrypa pas trupit.
- Kontrolloni që, në rast se ju ndodh diçka, ju dhe familja juaj do të keni mbulim mjekësor dhe sigurim.
- Përdorni identifikim të dukshëm nga një distancë nëse besoni se kjo do t’ju

sigurojë mbrojtje më të madhe. Fshihni ID-në tuaj dhe përpikuni të bashkoheni me njerëzit përreth jush nëse kjo duket më e përshtatshme sipas rrethanave.

- Ndani paratë tuaja në sasi më të vogla dhe mbajini në vende të ndryshme në veshje ose në një portofol shtesë.
- Rishikoni gjendjen e automjetit tuaj: kontrolloni gjithmonë, përpara nisjes, nëse keni një bombol zjarrfikëse funksionale, dhe më e rëndësishmja, se dini se si ta përdorni.
- Drejtuesit e mjeteve duhet të jenë gjithmonë vigjilentë. Protestuesit armiqësorë kanë shënjestruar makinat e shtypit. Merrni parasysh rregullat e agjencisë tuaj dhe diskutoni me ekipin tuaj nëse është më mirë që shoferi të qëndrojë jashtë automjetit, brenda tij me çelësin gati për t'u larguar shpejt nëse është e nevojshme.
- Pas parkimit, shoferi duhet të jetë i vëmendshëm dhe vigjilent. Nëse është e nevojshme, ai mund të marrë në konsideratë ndryshimin e pozicionit të mjetit, për të shmangur rrethimin dhe duhet të vërtetojë se ekipi i lajmeve është i informuar për pozicionin e tij të ri përpara ose gjatë lëvizjes.
- Kryerja e më shumë se një funksioni, si shoferi/kameraman, rrit rreziqet për gazetarët profesionistë.

Mos harroni...

- Përdorni gjithmonë një çantë shpine të lehtë, e cila hapet dhe mbyllet lehtë dhe që përshtatet mirë me trupin, duke lehtësuar aksesin dhe lëvizjen.

- Merrni ujë të pijshëm dhe ushqime me energji në rast se mbulimi zgjatet. Ndani ushqimin në pjesë të vogla. Mund t'ju duhet ta konsumoni atë gjatë ecjes për periudha të gjata kohore.
- Ekipet televizive duhet të zgjedhin pajisje të lehta, të cilat mund të transportohen lehtësisht. Jini të përgatitur për ta lënë atë pas nëse keni nevojë të largoheni shpejt.
- Përdorni një rrip dore ose një shenjë alarmi mjekësor që tregon grupin tuaj të gjakut ose ndonjë gjendje ose alergji të veçantë mjekësore.

b. Si të verproni gjatë protestës

- Kur të mbërrini në vengjarje, bëni një hartë mendore, duke identifikuar pozicionin e Policisë. Këto grupe të veçanta mund të ndodhen afër ose larg, jashtë pamjes së protestuesve. Është e rëndësishme të parashikohet se nga mund të vijnë ata dhe në cilin drejtim të vrapojnë në rast se japin një urdhër për t'u shpërndarë.
- Kini parasysh reagimet e protestuesve dhe ndryshimet në pozicionin e policisë. Lexoni shenjat kontekstuale të cila parashikojë rreziqet. Normalisht, një formacion i Policisë tregon qëllimin e tyre për të shpërndarë grupin. Shikoni përpara drejtimin që ka të ngjarë të marrë kjo lëvizje dhe planifikoni në përputhje me rrethanat.
- Shmangni vendet nëpër turmë; zgjidhni lëvizje specifike të fokusuara në regjistrimin e asaj që është e nevojshme.
- Konsideroni filmimin nga një pikë e favorshme e largët, nga anash ose nga lart.

- Mos merrni kurrë asgjë mbulese gjatë protestës. Mund të krijojë dyshime nga policia se ju jeni një protestues; jini të kujdesshëm ndaj çdo materiali të braktisur.
- Mos prekni copëzat nga granatat e lëshuara nga policia. Mund të jetë vdekjeprurese.
- Mos merrni anën e asnjë prej grupeve të përfshira.
- Kur filmoni, shmangni të rrethuarit nga pas nga policia e përfshirë në situatë. Qendroni mënjanë. Asnjëherë mos prekni një oficer policie me një armë në dorë – kjo është veçanërisht e rëndësishme për fotografët, të cilët janë mësuar të kërkojnë hapësirë për të marrë një kënd më të mirë.
- Mos harroni se individët e përfshirë në situatë mund të jenë të tensionuar dhe për këtë arsye reagojnë papritur ndaj çdo gjëje që ata e konsiderojnë si kërcënim.
- Fotoreporterët dhe operatorët e kamerës duhet të marrin me vete teleobjektiv që mundëson një pamje më të afërt të veprimit pa ekspozim të panevojshëm ndaj rrezikut.
- Mundohuni të shmangni marrjen e shumë fotove ose filmimin për periudha të gjata kohore të një personi të vetëm ose një grupi të vogël. Kjo mund të krijojë përshtypjen se ky person apo grup po kërcënohet.

c. Në rast se dhuna përshkallëzohet

- Nëse ju merret një objekt personal, duke përfshirë regjistrime video, kamera, aparati fotografik apo edhe shënimet demonstroi mosmiratimin tuaj. Deklaroni se ky është një akt censurimi, i cili është i ndaluar

me Kushtetutë, por mos u përfshini në diskutime të ashpra dhe mos prekni askënd.

- Në varësi të situatës, mund të mos këshillohet të thuash asgjë në atë moment. Mos u përballni me njerëzit me zemërim dhe respektoni hapësirën fizike të secilit individ. Vëzhgoni gjuhën e trupit. Njerëzit që gjestikulojnë shumë kanë nevojë për më shumë hapësirë rreth tyre. E njëjta gjë vlen edhe për ata që mbajnë armë. Toleroni fyerjet dhe jini të durueshëm.
- Mbani kontakt vizual kur jeni nën trysninë e pyetjeve. Nëse mbani syze të errëta, hiqni ato. Shikoni në sy pyetësit, merrni frymë thellë dhe përpiquni të ruani një ritëm të qetë dhe të matur në fjalët tuaja. Shmangni akuzat apo përshpejtimin e ritmit të diskutimit. Tregoni se nuk paraqisni një kërcënim.
- Nëse jeni arrestuar, bëni çdo përpjekje për të ruajtur sjelljen profesionale duke shpjeguar se jeni reporter dhe se puna juaj është të informoni popullatën; nëse, megjithatë, ju mbaheni të ndaluar nga policia, ndiqni udhëzimet dhe prisni një mundësi për të paraqitur çështjen tuaj me qetësi tek një oficer epror. Për më shumë, për situatat e ndalimit, lexoni faqet 13-17 më lart.
- Regjistrimi i bisedave tuaja mund të jetë i dobishëm në këtë moment. Regjistruarit e vegjël ose aplikacionet e smartfonëve mund të përdoren me kujdes dhe të shërbejnë si provë në favorin tuaj në një moment të dytë.
- Thoni gjithmonë të vërtetën dhe shmangni ndryshimin e historisë që tregoni. Qendroni të qetë dhe merrni një qendrim të përlulur. Mos harroni, objektivi juaj i vetëm në këtë

moment është të mbijetoni dhe të dilni nga situata i padëmtuar.

- Nëse jeni viktimë e një arrestimi të paligjshëm nga një punonjës i agjencive ligjzbatuese, njoftoni subjektet e shtypit dhe kërkoni praninë e një avokati.
- Nëse jeni sulmuar ose abuzuar, mbani shënim numrin e identitetit ose emrin e agresorit dhe raportojeni atë tek autoritetet (politikanë, prokurorë, avokat) agjencitë e shtypit dhe eprorët e agresorit.
- Nëse po ju fusin në një automjet policie, thoni me zë të lartë emrin tuaj dhe emrin e organizatës suaj mediatike në mënyrë që informacioni për arrestimin tuaj të fillojë të qarkullojë.

d. Çfarë duhet të bëni nëse jeni të ekspozuar ndaj gazit lotsjellës?

- Kushdo që ka raportuar lajmet mbi protestat dhe demonstratat paqësore e di fare mirë që ato mund të kthehen shpejt në mjedise të rrezikshme, për shkak të përdorimit të gazit lotsjellës.
- Kur kjo ndodh, rezultati është pothuajse gjithmonë i njëjtë: protestuesit ngecin në një re të trashë dhe mbytëse gazi lotsjellës.
- Kjo mund të tingëllojë si diçka me të cilën nuk do të duhet domosdoshmërisht të përballeni, por po ndodh prej vitesh dhe po ndodh tani në mbarë botën që turmat janë duke u shtypur dhunshëm dhe goditur me gaz gjatë protestave.

- Kur jeni të ekspozuar ndaj gazit lotsjellës, sytë ju djegin, shikimi turbullohet dhe ju rrjedhin lot dhe nuk jeni në gjendje për ta kontrolluar. Gjendja përkeqësohet sa më gjatë të jeni të ekspozuar në gaz. Pas disa sekondash, nuk do të jeni në gjendje të shihni, gjë që do t'ju ç'orientojë dhe hutojë, potencialisht deri në pikën e shqetësimit emocional dhe psikologjik.
- Por kjo nuk është e gjitha. Pluhuri gjithashtu irriton rrugët e frymëmarrjes, duke e bërë të vështirë frymëmarrjen dhe bën që gjoksi të shtrëngohet. Do të filloni të kolliteni automatikisht dhe hunda e goja juaj do të sekretojnë respektivisht sasi të bollshme mukusi e pështyme. Ky është një mekanizëm mbrojtës, por paradoksalisht do t'i përkeqësojë simptomat. Disa njerëz raportojnë se ndjehen sikur po mbyten në sekrecionet e tyre dhe, nëse nuk lëvizni nga reja e gazit, më shumë mukus do t'i japë pluhurit më shumë mundësi për t'u ngjitur dhe situata përkeqësohet.
- Po, kjo duket e frikshme, por marrja e masave paraprake minimale do t'ju ndihmojë të zvogëloni këto simptoma, të lëvizni në siguri dhe me shpresë të ndihmoni të tjerët gjatë rrugës.
- Vishni një shall që mund të mbulojë gojën dhe hundën. Maskat e zakonshme që përdoren kundra Covid, janë gjithashtu një opsion.
- Mënyra e vetme plotësisht efektive për t'u mbrojtur nga gazi lotsjellës është të vishni një maskë gazi, por ka shumë të ngjarë që ju të mos keni një të tillë. Në këtë rast ju

duhet të mbuloni hundën dhe gojën tuaj me një shall, fashë, ose maskë të lagur në ujë. Kjo do të parandalojë që pluhuri të futet në rrugët e frymëmarrjes, gjë që do t'ju lejojë të merrni frymë.

- Mbuloni kokën. Kujtoni që ky veprim nuk rekomandohet në rrethana të tjera, siç shpjegohet më lart, përveç se kur përballeni drejtpërdrejt me gazin lotsjellës.
- Nëse mund të krijoni një zgjidhje gjithëpërfshirëse me një shall të madh që do të mbulojë rrugët e frymëmarrjes dhe të gjithë kokën tuaj, edhe më mirë. Nëse nuk e keni një të tillë, një kapelë mbrojtëse është mjaftueshëm e mirë. Sigurohuni që të mbuloni sa më shumë kokën tuaj dhe nëse keni flokë të gjatë, lidhini ato në një topuz ose gërshet.
- Mbani gjithmonë syze. Ato mund të mos jenë aksesorët e zakonshëm të modës, por një palë syze skish ose noti do të parandalojnë hyrjen e grimcave të gazit lotsjellës në sytë tuaj.
- Mbuloni sa më shumë lëkurën tuaj. Ky mund të jetë një problem në temperaturat më të larta, por nëse duhet të zgjidhni një veshje për një protestë, maksimumi është: Sa më pak lëkurë dhe sa më e dendur të jetë pëlhura, aq më mirë. Hiqni dorë nga preference e pantallonave të shkurtra, por zgjidhni këmisha me mëngë të gjata - kjo do të thotë më pak sipërfaqe ku gazi duhet të ngjitet. Vini re se pluhuri CS ngjitet në rrobat tuaja, kështu që nëse jeni të ekspozuar, do t'ju duhet të ndryshoni sa më shpejt të jetë e mundur.

- Mbajini gjërat në shpinë.
- Nëse keni nevojë të vraponi dhe të mbani një çantë mbi sup mund të jetë vërtet e pakëndshme.

5. Si të ruheni nga përgjimi?

- Telefoni, ky mjet i domosodshëm në punën jo vetëm të një gazetari mund të shndërrohet në spiunin tuaj kryesor.
- Nuk ka asnjë sinjal që ju të kuptoni se telefoni juaj është nën përgjim. Ndaj është shumë e rëndësishme që të tregoni kujdes që nëpërmjet aplikacioneve të ndryshme, jo vetëm që telefoni juaj të mos jetë nën sulm, por mos të shndërrohet në një indetifikues të vendodhjes dhe dekonspirimit të bisedave.
- Mos i përmendni planet tuaja në rrjetet sociale ose me kolegët tuaj. Përdorni gjithmonë platforma të koduara dhe kurrë mos tregoni vendodhjen tuaj apo dhe te takimeve tuaja.
- Për më shumë, ndiq këshillat e dhëna më lart në faqet 17-20.

6. Si të mbroheni nga ndjekja/mbikqyrja?

- Bëhuni spontan me rutinat tuaja – jo për të më shmangur vëzhguesin, por thjesht për rritur koston e ndjekjes. Ajo mund të ndodhë gjithsesi.
- Bëni sikur lexoni shkrimet në dritaret e bareve dhe restoranteve ndërsa skanoni rastësisht për njerëz që bien në sy apo edhe ata që bëjnë sikur lexojnë gjithashtu këto shkrime.

- Ndërsa ecni, vazhdoni të bëni kthesa, jo duke i rënë rreth e rrotull një blloku pallatesh, por bëni zig-zag dhe kushtojini vëmendje atyre që janë pas jush.
- Kushtojini vëmendje këpucëve të njerëzve. Ato janë një tregues i mirë për atë që personi ka planifikuar të bëjë. Një mbikëqyrës preferon të veshë atlete në verë për rehati dhe çizme në dimër.
- Kërkojini një shoku të monitorojë makinat pas jush - veçanërisht në kryqëzime.
- Ndonjëherë, për arsye kostoje ato operojnë me një makinë që ju ndjek nga pas.
- Kërkoni ndihmën e një miku për të parë nëse jeni nën ndjkeje. Nëse konstatohen shenja si për shembull makina pas jush ju ndjek në çdo kthesë, më pas zhduket për për t'u rishfaqur pas jush një bllok më vonë. Nëse kjo ndodh dy herë, ju jeni zyrtarisht nën mbikëqyrje.
- Përdorni mënyra të ndryshme transporti dhe ecni kundër fluksit të trafikut në rrugë me një drejtim.
- Rëndoni koston e atyre që ju mbikëqyrin. Përpiquni të gjeni banesa të tjera ku të kaloni natën, në këtë mënyrë të paktën do të bëni që vëzhguesi juaj të kalojë natën jashtë në makinë.
- Përdorni një dalje tjetër, veçanërisht në qendrat tregtare. Kur keni një takim të rëndësishëm për të shkuar, bëni një plan për të hequr mbikëqyrjen në një mënyrë që ata të mos e kuptojnë se është bërë me qëllim. Ndërtesat e mëdha me dalje të shumta janë ideale.

- Nëse përdorni një dalje tjetër në një qendër tregtare, ata do t'ju gjejnë përsëri në shtëpinë tuaj në fund të ditës, por ju keni pasur disa orë privatësi.
- Duhet të paralajmëroni burimet dhe redaktorët tuaj se jeni nën mbikqyrje. Nëse mendoni se jeni në rrezik imediat, duhet të shkoni në polici. Por nëse e bëni këtë, do t'ju duhet t'u përgjigjeni pyetjeve mbi përkrahjet - ngjyrën, markën dhe modelin e makinës, ose një targë; çdo veçori dalluese; ku dhe kur u vendosët nën vëzhgim.
- Mos iu afroni njerëzve që ju ndjekin dhe mos lejoni që ata të kuptojnë se e keni vënë re.
- Është e rëndësishme të mos e lini ekipin e vëzhgimit të dijë se jeni në dijeni të tyre, sepse mund të përshkallëzohet drejt kërcënimeve ose dhunës.
- Kurrë mos u bëni karshëllik por ju mund të lëvizni nga një vend në tjetrin – bëni ekipin të lodhet nga ndryshimet tuaja të mendjes, kështu që ata nuk mund të shkojnë të kryejnë nevojat personale apo të pushojnë.
- Organizoni takime të rëndësishme në gjykata apo zonat e aeroportit, përtej pikave të kontrollit të sigurisë.
- Takohuni me burimet tuaja një gjykatë me kontroll të rreptë, ku ekipi që ju mbikqyr nuk mund të mbajë pajisje elektronike brenda dhe do të detyrohej të kalonte përmes sigurisë.
- Nëse jeni nën mbikqyrje nga agjentë qeveritarë, kërkoni këshilla nga avokatët dhe organizatat jofitimprurëse që merren me çështje të sigurisë dhe të të drejtave të njeriut.

IV. ÇFARË TË BËNI PAS NJË SITUATE KËRCËNUESE?

1. Çfarë të bësh kur ndihesh i kërcënuar?

- Injorimi i kërcënimeve funksionon deri në një masë të caktuar. Nëse kërcënimet bëhen të qarta ose filloni të keni frikë për sigurinë tuaj, mos hezitoni të raportoni menjëherë te botuesi juaj.
- Mos vlerësoni vetë nëse kërcënimi është serioz apo jo.
- Mos prisni deri më vonë gjatë ditës me idenë që keni intervista apo punë të tjera për të bërë.
- Kontakto me një avokat apo organizatë të shoqërisë civile që ka në fokus mbrojtjen e gazetarëve.
- Denonco rastin në organet e prokurorisë ose policisë.

2. Te cilat organizata të drejtohesh për të kërkuar ndihmë?

Njëlistë e shkurtër e organizatave ndërkombëtare ose vendase që mund të ofrojnë ndihmë janë:

- Këshilli i Evropës
- OSBE

- European Centre for Press and Media Freedom (Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias)
- Unioni i Gazetarëve
- Qendra “Res Publica”
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit
- Klinikat e ligjit pranë fakulteteve të drejtësisë

Mekanizma ndërkombëtarë ku mund të drejtoheni në rast të cenimit të lirisë së shprehjes janë edhe:

- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mbani mend që kjo gjykatë ju dëgjon vetëm nëse i keni ezauruar mjetet e brendshme të ankimit (gjykatat vendase), por në raste të posaçme mund ta anashkalojë këtë rregull, kur është rasti që mjetet e brendshme të ankimit nuk janë efektive. Për më shumë kontaktoni një avokat.
- Komiteti i të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara. Rregulli i mësipërm vlen edhe për këtë organ, por me disa ndryshime të vogla avantazhuese dhe disavantazhuese. Avantazhi qendron në faktin që gjykimi zgjat më pak kohë dhe nuk ka një afat maksimal se kur mund ta paraqisni ankesën. Disavantazhi qendron në faktin që vendimi nuk është detyrues për qeverinë, si dhe dokumentacioni i dorëzuar duhet të jetë i gjithi në gjuhën angleze. Për më shumë kontaktoni një avokat.

3. Çfarë të bëni nëse goditeni për shkak të detyrës ose në rast kanosje?

- Së pari, evidentoni nëse kërcënimi apo goditja (rrahja/plagosja) ka ndodhur për

shkak të detyrës apo për shkaqe të tjera. Për shembull nëse dikush ju “kërcënon” me një mesazh se do t’ju vrasë, apo ju godet meqë po shprehni publikisht disa qendrite rreth orientimit seksual, kjo nuk është kanosje apo goditje për shkak të detyrës. Ndonjëherë nuk është e thjeshtë të identifikohet qartë shkaku i kërcënimit, por kjo është e rëndësishme pasi nga kjo varet mënyra e adresimit të problemit dhe rrethanat përkatëse. Kujtoni që nuk mbrohet gazetari, por mbrohet gazetiaria si funksion i nevojshëm në një shoqëri demokratike!

- Nëse konstatooni se jeni kanosur për shkak të detyrës (neni 238 i Kodit Penal), goditur për shkak të detyrës (neni 237 i Kodit Penal), është goditur një anëtar i familjes suaj për shkak të detyrës suaj (neni 243 i Kodit Penal), apo konstatooni ndërhyrje të padrejta në jetë tuaj private (si përgjimi) për shkak të detyrës (neni 121, paragrafi 4, i Kodit Penal), denonconi në organet e policisë, të cilat janë të detyruara ta ndjekin çështjen kryesisht.
- Kujdes, në rast të çdo cenimi për shkak të detyrës, duhet provuar karakteristika juaj si gazetar me anë të një marrëveshje (kontratë pune) për të cilën ju ushtroni funksionin e gazetarit. Sipas Gjykatës së Lartë, në një vendim të vitit 2011, gazetarët që nuk kanë kontratë pune, nuk klasifikohen se kanë qenë në kushtet e kryerjes së detyrës dhe që janë goditur për shkak të saj. Kjo situatë mund të provohet edhe me dokumenta të tjerë, sipas rastit, për gazetarët freelance. Për më shumë kontaktoni një avokat, ose një OJF që ofron ndihmë juridike të posaçme për gazetarët.

- Nëse goditja ka ardhur si pasojë e arsyeve të tjera që nuk lidhen me punën tuaj si gazetar, pavarësisht se ju jeni gazetar, ju duhet të paraqisni drejtpërdrejt një kërkesë në Gjykatë, për ndjekjen e çështjes si viktimë akuzuese. Në këto raste prokuroria nuk do të konkludojë me fillim hetimesh, prandaj do ju duhet të ndiqni veprimet e sugjeruara më sipër në këtë paragraf.
- Në çdo rast kontakto një avokat ose organizatë që ka në objekt të veprimtarisë së vet mrojtjen e gazetarëve për të marrë asistencë të specializuar. Këto raste paraqesin komplikacione të shumta dhe asistencë e një profesionisti është e domosdoshme.

4. Si të veprosh për tu mbrojtur nga kallëzimet/paditë e bëra nga zyrtarët (Paditë SLAPP)?

SLAPP është një akronimi i fjalëve *Strategic Litigation Against Public Participation* (gjqye strategjike kundër pjesëmarrjes publike). Këto padi, apo kërkesa penale, synojnë të censurojnë, frikësojnë dhe të bëjnë të heshtin zërat kritikë, duke i ngarkuar ata me koston e një mbrojtjeje ligjore derisa ata të braktisin punën e tyre kritikuese ose kundërshtuese.

Në rastin tipik të një SLAPP-i, paditësi normalisht nuk pret të fitojë padinë. Qëllimet e tij arrihen nëse i padituri i nënshtrohet frikës, pasigurisë, rritjes së kostove ligjore ose thjesht lodhjes dhe braktis punën kritike. Në disa raste, proceset gjyqësore të përsëritura dhe joserioze kundër një të padituri gazetar ndërhyjnë në aftësinë e tij dhe/ose të organizatës mediatike për të operuar.

SLAPP sjell shqetësime për lirinë e shprehjes për shkak të efektit të tyre frikësues dhe shpesh është e vështirë për t'u filtruar paraprakisht nga sistemi gjyqësor sepse paditësit përpiqen ta fshehin qëllimin e tyre për të censuruar, frikësuar ose heshtur kritikët e tyre.

Ekziston një numër i konsiderueshëm individësh apo subjektësh (veçanërisht politikanë apo subjekte biznesi nën kritika publike) që padisin gazetarë në gjykatë.

Për t'u mbrojtur nga paditë SLAPP nevojitet:

- Siguroni një bashkëpunim të konsoliduar me organizata që ofrojnë ndihmë juridike për gazetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë para gjykatës në rastet e shpifjeve dhe fyerjeve, në të gjitha fazat e procedimit. Organizata të tilla janë Res Publica, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, klinikat e ligjit të ndërtuara në fakultetet e drejtësisë, etj.
- Siguroni kontakte të menjëhershme me rrjete organizatash që zhvillojnë programe për të mbështetur gazetarët me kosto dhe shpenzime për çështjet që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes siç është European Centre for Press and Media Freedom. Për më shumë informacion vizitoni www.ecpmf.eu.

Mbrojtja më e mirë nga paditë e të gjitha llojeve është parandalimi.

Për efekt të parandalimit të çdo aksioni ligjor kundër jush, ndiqni këshillat konkrete të mëposhtme se çfarë duhet të bëni dhe çfarë nuk duhet të bëni.

a. Gjithmonë konsultohuni me Kodin e Etikës

Gjithmonë konsultohuni me Kodin e Etikës, si dhe kodet e tjera më të specializuara të sjelljes dhe udhëzimet përkatëse. Pajtueshmëria me dispozitat e tyre do të kenë peshë të rëndësishme në vlerësimin e gjykatës nëse veprimi juaj është i justifikuar brenda kufijve të shprehjes. Sot ekziston një organ i tillë vetërregullues në Shqipëri që quhet Aleanca e Mediave Etike, e cila ka zhvilluar një kod etike të mirë.

b. Zgjidhni temat me kujdes.

Veprimet dhe mosveprimet e politikanëve dhe qeveritarëve duhet të jenë fushat kryesore në fokusin tuaj, së bashku me ndonjë çështje tjetër të interesit publik (dmth çdo çështje që publiku pritet të ketë interes ose temat që janë aktualisht objekt i debateve publike). Mangësitë dhe problemet e institucioneve shtetërore (policisë, sistemit të drejtësisë, ushtrisë) gjithashtu mund dhe duhet të jenë nën vëzhgimin e shtypit. Kufijtë e kritikës së lejueshme ndaj zyrtarëve shtetërorë megjithatë janë më të ulëta se ato të zbatueshme për politikanët dhe mund të jetë një ide e mirë të mos përmendet identiteti i zyrtarëve që nuk janë në nivel politik (p.sh. referohuni atyre duke përdorur inicialet). Raportimi mund të shtrihet edhe për individët privatë dhe subjektet jo-qeveritare (të tilla si kompani apo ndërmarrje) që megjithëse të tillë, ata me dashje të hyjnë në “arenën publike”.

Gjithmonë duhet të mbani mend, se e drejta juaj për lirinë e shprehjes, madje edhe për çështje politike, nuk është absolute. Kështu për shembull, me vështirësi dhe në raste tepër të veçantë ndodh që gjykata të pranojë që një artikull për jetën private dhe familjare të një politikani i shërben interesit publik.

c. Shkruani artikujt në mirëbesim

Mbani mend se në mënyrë që ju të përfitoni nga mbrojtja, duhet që të jeni në gjendje të provoni se puna juaj kontribuon në interes të publikut dhe nuk është vetëm një shprehje e armiqësisë tuaj personale kundër një politikani, zyrtari apo personi të biznesit. Për këtë qëllim, ju duhet gjithmonë të siguroheni se artikujt tuaj kanë të paktën një bazë faktesh dhe të përpiqeni për t'i siguruar lexuesit referenca, ose versionin e historisë së atyre që janë në fokus, në mënyrë që lexuesi të mund të formojnë vetë mendimin. Përpiquni të kontaktoni personin që ju jeni duke kritikuar në artikull në kohën e duhur, për të përfshirë edhe versionin e tyre të ngjarjeve që po raportoni, dhe gjithmonë botoni ndreqjet përkatëse nëse vërtetohet më vonë që keni qenë të pasaktë.

d. Kini parasysh që koha është vendimtare dhe është e drejtë që të mos prisni e ta shtyni kohën e publikimit të një historie të rëndësishme

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) pranon se në fushën e medias koha është vendimtare dhe se një gazetar nuk mund të kërkohet gjithmonë të shtyjë publikimin e një historie, në mënyrë që të kryejë hulumtime të mëtejshme në lidhje me të - megjithatë, ai duhet të jetë në gjendje të provojë se në kohën e botimit kishte marrë të gjitha masat e mundshme dhe të domosdoshme në rrethanat përkatëse, në mënyrë që të sigurojë që, në kohën e botimit, akuzat/kritikat ishin të bazuara mirë.

Lidhur me natyrën e gjuhës së përdorur, Gjykata pranon se gjuha e ekzagjeruar, madje edhe provokuese mund të përdoret, sidomos në rastet kur personi në fjalë ka përdorur gjuhë të ngjashme të parë.

e. Tregoni kujdes me disa tema apo çështje që për arsye historike apo sociale mund të jenë veçanërisht të ndjeshme për shoqërinë

Gjithmonë kini parasysh që disa tema apo çështje që keni vendosur për të trajtuar në artikujt tuaj, për arsye historike apo sociale mund të jenë veçanërisht të ndjeshme për shoqërinë apo grupime të veçanta.

Gjithsesi, sa më sipër nuk do të thotë se ju duhet të frenoni veten lidhur me trajtimin e tyre, por duhet të jeni më të kujdesshëm në raportimin e tyre në publik, duke shmangur gjuhën provokuese të padrejtë apo teknikat prezantuese që nuk marrin parasysh kontekstin e veçantë social dhe historik.

f. Shmangni deklaratimet për faktet për të cilat nuk jeni të sigurtë dhe zëvendesojini me opinionet tuaja

Shpesh ndodh që të referohet një fakt si i vërtetë, por nuk ka siguri pa pasur provat në dorë. Në këto kushte mund të shprehni më shumë opinione (gjykime vlerësuese sipas GJEDNJ). Megjithatë gjithmonë mos harroni, se edhe opinionet duhet të kenë disa baza faktike. Është e pamundur të sigurohet një listë e kushteve që gjithmonë do të shkonin mirë në një përshkrim fakti ose në një opinion. Një vlerësim i tillë do të varet shumë nga konteksti në të cilin termi në fjalë është shprehur. Në përgjithësi, një term ose një shprehje, që mund të interpretohet se tregon që një person ka kryer një vepër penale, do të konsiderohet si fakt dhe në gjykatë mund t'ju kërkohet që të sillni prova për të vërtetuar që akuzat tuaja janë të vërteta. Por mos harroni se ju nuk jeni të detyruar që të mblidhni dhe t'i siguron lexuesit tuaj “prova përtej dyshimit të arsyeshëm”.

g. Mbështetuni në dokumenta zyrtare

Ju mund të mbështeteni në dokumente zyrtare, pa pasur nevojë të verifikoni saktësinë e përmbajtjes së tyre, por mos u mbështesni në mënyrë jokritike tek interpretime të të tjerëve të dokumenteve zyrtare pa u konsultuar vetë me to.

h. Përpiquni të siguronit informacion të besueshëm dhe kërkoni informacion nga autoritetet shtetërore

Gjithmonë duhet të përpiqeni të merrni informacion të besueshëm në lidhje me temën që ju po bëni kërkime, dhe gjithmonë adresoni kërkesa autoriteteve shtetërore për informacionin përkatës. Nëse ata nuk e vënë informacionin në dispozicion në kohën e duhur, ose e refuzojnë atë, atëherë ju mund të përdorni në mënyrë të mençur çdo informacion në dispozicionin tuaj, madje edhe të informatave që rrjedhin nga burime të besueshme (por të jeni të kujdesshëm për të njoftuar lexuesit tuaj se burimet janë të pakonfirmuara zyrtarisht). Mos harroni, ju nuk jeni gjyqtar dhe nuk jeni të detyruar të mblidhni prova përfundimtare para se të botoni historinë tuaj.

Përdorni favoret që ofron ligji për të drejtën e informimit. Në rast refuzimi të dhënies së informacionit ankohuni te Komisioneri për të Drejtën e Informimit. Nëse nuk e njihni mirë procedurën, ose nuk keni shumë kohë në dispozicion, apo nuk ndiqni dot afatet, drejtohuni te Publeaks.al. Nëse skanoni kodin QR në pjesën e pasme të kopertinës së kësaj broshure, do ju jepet mundësia të instaloni aplikacionin mobil të këtij shërbimi që operohet nga qendra Res Publica.

Për raportimet nga gjykatat, mos hezitoni të paraqisni ankesa te Gjyqtari i Medias, i cili caktohet pranë çdo gjykate apeli, mbulon dhe gjykatat e shkallëve të para dhe zgjidh problemet e aksesimit të informacioneve të vlefshme nga veprimtaria e gjykatave.

i. Keni të drejtë të refuzoni zbulimin e burimeve tuaja ose të dorëzoni materiale nëse kjo kërkohet nga autoritetet

GJEDNJ ka pranuar se detyrimi i gazetarëve të zbulojnë burimet e tyre të informacionit do të parandalonte ata nga ushtrimi i funksionit të tyre, pasi askush nuk do të ishte më i gatshëm për të ndarë informacion me ta. Megjithatë mbani mend se ky aspekt nuk është absolut, kështu vetëm në raste tepër ekstreme gjykata do të konstatojë se masa të tilla janë në pajtim me standardet e lirisë së shprehjes. Gjithashtu vini re se jo të gjitha burimet e informacionit janë të mbrojtur, siç janë personat e filmuar / regjistruar fshehurazi, të cilët nuk kualifikohen si burime dhe prandaj nuk janë të mbrojtur në të njëjtin nivel si burime gazetareske.

j. Ndaj formave të shprehjeve raciste, ksenofobe dhe gjuhës e urrejtjes, anti-semite, nuk ekziston mbrojtje për gazetarin

GJEDNJ ka mbajtur qendrim të ashpër ndaj formave të shprehjeve raciste, ksenofobe dhe gjuhën e urrejtjes, anti-semite. Jo vetëm që Gjykata e ka bërë të qartë se nuk ka asnjë interes publik që mund të legjitimojë një fjalim të tillë, por në disa raste ka mbajtur qendrimin edhe se një fjalim i tillë nuk është vetëm tronditës dhe fytes, por edhe armiqësor ndaj vlerave themelore demokratike të Konventës. Fjalime të tilla bien krejtësisht jashtë sferës së mbrojtëse dhe janë në kundërshtim me nenin 17 të Konventës.

5. Si të veproni kur ju rrezikohen burimet nga sekuestrimi i pajisjeve elektronike?

- Mos dorëzoni asnjë send organeve proceduese (telefon, laptop, server) nëse nuk iu paraqitet një Vendim Gjykatë, i cili përban urdhërin e sekuestrimit.
- Në rast se ju paraqitet një Vendim Gjykatë shmangni kohën e ekzekutimit, në mënyrë që të fitoni kohë për të ndjekur çështjen ligjërish. Kontaktoni menjëherë me një avokat, i cili do t'ju ndihmojë të ruani të drejtat tuaja gjatë sekuestrimit ose të paraqisni kërkesat procedurale për ta kundërshtuar atë. Sipas ligjit, mbrojtja e burimeve të gazetarit nuk është një e drejtë absolute, por ka raste kur një veprim i tillë justifikohet, siç është rasti kur prova ka rëndësi vendimtare për hetimin dhe nuk ekzistojnë mundësi të tjera për të zbuluar të vërtetën. Sipas ligjit lejohet sekuestrimi i të dhënave, por jo i pajisjeve. Sipas ligjit, gjithashtu, lejohet sekuestrimi vetëm kur bëhet fjalë për krime (vepra penale që dënohen në maksimum me mbi 2 vjet burgim), dhe jo për kundravajtje penale (që dënohen në maksimum deri në 2 vjet burgim). Tashmë GJEDNJ ka vendosur një precedent në rastin e Lapsi.al dhe praktika gjyqësore shqiptare po ndryshon në drejtim të qartësimit të modaliteteve të këtyre sekuestrimeve kur rrezikohen burimet e gazetarit.
- Në çdo rast mos harroni të prezantoheni si gazetar dhe të vini në dukje faktin se sendet përmbajnë të dhëna që cenojnë burimet tuaja.

- Gjatë cdo procedure kërkoni të mbahet procesverbal, në të cilin ju të keni mundësi të shënoni vërejtjet tuaja.

V. KËSHILLA TË TJERA TË PËRGJITHSHME

1. Rrisni sigurinë mes rritjes së profesionalizmit

Shkruani në një mënyrë që të krijojë siguri. Qëllimi është të shkruani një histori në atë mënyrë që askush të mos të dëshirojë t'ju kërcënojë kur të publikohet. Mbani para sysh:

- Gazetaria e mirë dhe etike e zbut rrezikun.
- Raportimi duhet të jetë i drejtë, i saktë dhe i balancuar.
- Shkruani të mbështetur në informacion sa më të sigurtë. Jepini edhe personit më të keq një shans për të treguar anën e tij të historisë dhe përfshijeni atë.
- Ju kryeni detyrën tuaj dhe asgjë nuk duhet të paraqitet si personale.
- Sa më profesionistë të jeni, aq më shumë ka gjasa që ata t'ju shohin si profesionist dhe të rezervojnë një trajtim të zbutur.
- Qëndroni larg bashkëshortëve, fëmijëve, të dashurve/dashurave ose çështjeve personale të tyre, përveç rasteve kur edhe ata janë të përfshirë në kriminalitet.
- Mos u përpiqni të turpëroni njerëzit. Trajtojini të gjithë me respekt.

- Kontrollonini të gjitha faktet dhe bëni korrigjime për të gjitha gabimet e hasura para publikimit.
- Mos bëni “lojën e tyre”.

Gazetari që sillet si kamikaz është i rrezikuar. Ai:

- Shkakton ndjenjën e persekutimit;
- Eliminon dialogun;
- Krijon zemërim/zhgënjim të justifikuar;
- Krijon një situatë ku eliminimi i reporterit eliminon problemin.

2. Raportimi i kronikës së zezë

a. Ballafaqimi me traumat dhe viktimat

Gjithmonë do ju vijë rasti të gjeni fytyra njerëzore, të vizitoni shtëpitë dhe vendet e punës dhe t’u bëni njerëzve pyetje të pakëndshme për historitë. Por viktimat mund të jenë të traumatizuar. Ata mund të mos duan të identifikohen dhe të diskutojnë për ngjarjen. Edhe emërtimi i vendit ku jeton viktimat mund të krijojë probleme me komunitetin, duke e lënë familjen e viktimës edhe më të pasigurt. Disa këshilla që mund të japim janë:

- Trajtonini viktimat me dinjitet. Lëreni viktimën t’ju “ftojë” në historinë e vet.
- Lëreni viktimën të diktojë kohën dhe vendosjen e intervistave.
- Jini transparent. Merrni pëlqimin e informuar se si do të identifikohet viktimat.

- Vendos njerëzoren përpara historisë. Së pari jepni përparësi mirëqenies së viktimës, së dyti historisë.
- Mos e mbingarkoni fillimisht me pyetjet më të vështira. Kini empati dhe dëgjoni.
- Ballafaqimi i përsëritur me viktimat e traumatizuara mund të ndikojë tek ju.

b. Si të planifikosh sigurinë në takime të rrezikshme?

- Në këto takime gazetarët rekomandohen të shkojnë të shoqëruar.
- Të gjitha takimet duhet të jenë në vende publike.
- Rekomandohet që një person i tretë të monitorojë takimin.
- Policia ose forca private sigurie mund të mbahen në gatishmëri.
- Redaktorët duhet të monitorojnë situatën.
- Për këto raste, duhet të ketë një mënyrë për të gjurmuar vendndodhjen e gazetarit në çdo kohë.

c. Si të ballafaqohesh me njerëz të rrezikshëm?

- Shpjegoni se po kryenin detyrën e tuaj dhe asgjë nuk është personale.
- Bëhuni profesionist dhe shpjegoni se çfarë do të realizoni.
- Mos u miqësoni me ta - NUK jeni miku i tyre.
- Mos merrni përgjegjësi për historinë - kjo është puna e redaktorit - ju nuk punoni vetëm.

- Shmangni provokimet dhe karshillëkun

Për më shumë siguri:

- Shpjegoni se si e keni metodën e punës.
- Sigurohuni që të komunikoni qartë pa krijuar ekuivoke.
- Mos bëni premtime.
- Mos gënjeni apo mashtroni.
- Mos vidhni dokumente e sende.
- Sigurohuni që të jeni të besueshëm.
- Sigurohuni që të jeni të përgjegjshëm.

d. Si të vlerësoni kërcënimet?

- Të gjitha kërcënimet janë të ndryshme.
- Kuptoni gjendjen, mos nënvlerësoni dhe mos ekzagjeroni.
- Raportoni menjëherë te redaktorët të gjitha kërcënimet.
- Redaktorët mund të dëshirojnë t'i raportojnë kërcënimet policisë, OJF-ve ose autoriteteve të tjera. Por mund të ketë raste që ata nuk dëshirojnë ta bëjnë këtë gjë.
- Për kërcënimet anonime përpiquni të merrni sa më shumë informacion që është e mundur (për shembull nga telefonuesi) se pse jeni duke u kërcënuar.
- Mbani kopjet e mesazheve kërcënuese nëse është e mundur. Nëse jo, shkruani menjëherë gjithçka që mbani mend.

- Mos debatoni me personin që ju kërcënon, merreni me qetësi ose mos bëni “të fortin”. Tregojini këtij personi se nuk keni kontroll mbi historinë dhe pyesni nëse ai dëshiron të flasë me redaktorin tuaj.
- Në varësi të besueshmërisë së kërcënimit, redaktorët duhet të konsiderojnë ose pezullimin e lajmit, ndryshimin e reporterëve, dërgimin e gazetarit me pushime ose sjelljen e personelit të sigurisë.

3. Këshilla për gazetarët që mbulojnë Covid-19

Koronavirusi është bërë tashmë historia më e madhe e botës dhe një nga gjashtë emergjencat globale të shëndetit publik të shpallura vitet e fundit nga OBSH, duke filluar me gripin e dërrit të vitit 2009.

Pavarësisht të gjitha këtyre shifrave dhe vlerësimeve, është e vështirë të kuptohet se sa larg mund të përhapet Covid-19 dhe cilat do të jenë pasojat përfundimtare. Me të gjitha paqartësitë, gazetarët në mbarë botën përballen me sfidat e shumta të mbulimit të epidemisë – duke përfshirë luftimin e dezinformimit dhe rreziqeve shëndetësore për gazetarët në terren – duke mos harruar edhe panikun.

a. Si mund të shmangim përhapjen e panikut?

Një profesore e gazetarisë në Universitetin e Cardiff, ekzaminoi se si frika ka luajtur një rol në mbulimin e Covid-19 në 100 gazeta me tirazh të lartë nga e gjithë bota. Ajo zbuloi se një në çdo nëntë histori me audiencë të gjerë përmendi fjalën “frikë” ose fjalë të lidhura me të, duke përfshirë vrasjen, vdekjen, shfarosjen.

Është e rëndësishme të shmanget përhapja e panikut ndërkohë që vazhdohet të ofrohet mbulim i thellë dhe i ekuilibruar!

- Reduktoni në maksimum përdorimin e epitetëve subjektive në raportim; për shembull: sëmundje “vdekjeprurëse”.
- Përdorni fotot me kujdes për të shmangur përhapjen e mesazhit të gabuar.
- Shpjegoni veprimet parandaluese; mund ta bëjë historinë tuaj më pak të frikshme.
- Mos harroni se historitë statistikore janë më pak të frikshme se ato anekdotike.
- Shmangni titujt që synojnë kapjen e klikimeve dhe jini krijues në prezantim.
- Theksoni gjetjen e fakteve dhe jo fjalimet. Kjo është një histori shkencore, jo politike
- Mbështetuni tek ekspertët mjekësorë.

b. Mbrojtja nga infektimi gjatë mbulimit të ngjarjes në terren

Duke u përballur me një shpërthim global të sëmundjes, gazetarët nuk mund ta mbulojnë ngjarjen nga vetë-karantina. Ata duhet të shkojnë në terren edhe pse ka rrezik të infektohen. Merrni masat mbrojtëse të rekomanduara nëse vizitoni një vend të infektuar, si p.sh. një vend i trajtimit mjekësor. Evitoni prekjen e sipërfaqeve që mund të jenë të kontaminuara. Mos i vendosni kurrë pajisjet në dysheme.

c. Si të raportojmë për pandeminë?

Ekspertët e sëmundjes nuk janë të lehtë për t'u gjetur. Virusi është i panjohur dhe i

paparashikueshëm dhe nuk ka mjaft studiues apo mjekë të specializuar për Covid-19. Kur zgjidhni ekspertë, merrni parasysh sugjerimet e mëposhtme:

- Zgjidhni ekspertët me kujdes. Marrja e një çmimi Nobel për një lëndë shkencore nuk e bën dikë një autoritet në të gjitha temat shkencore. As të kesh një doktoraturë ose të japësh mësim në një shkollë prestigjioze mjekësore. Dalloni atë që dihet se është e vërtetë nga ajo që mendohet të jetë e vërtetë - dhe çfarë është spekulimi ose opinioni.
- Tregoni kujdes kur citoni gjetje nga “printimet paraprake” ose punimet akademike të pabotuara.
- Kërkojuni akademikëve ndihmë për të vlerësuar vlerën e lajmeve të teorive dhe pretendimeve të reja.
- Për të parandaluar përhapjen e dezinformimit, duhet të kontrolloni faktet. “Ne nuk po luftojmë vetëm një epidemi; ne po luftojmë një infodemi,” tha Drejtori i Përgjithshëm i OBSH-së Tedros Adhanom Ghebreyesus në Konferencën e Sigurisë në Mynih më 15 shkurt. Në këtë epokë të keqinformimit dhe dezinformimit, miteve në internet dhe teorive konspirative, gazetarët gjithashtu mund të zhbëjnë keqinformimin.
- Kuptoni gjendjen shpirtërore në terren - më pas përkthejeni atë në punën tuaj.
- Përqendrohuni në raportim, jo në analizë.
- Bëni kujdes me titujt.
- Mbani mend: Jo të gjitha shifrat janë të sakta.

- Flisni me sa më shumë njerëz të ndryshëm.
- Shmangni fraza raciste.

* * *



Res Publica është një organizatë për interesin publik, e cila punon për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat themelore të njeriut përmes litigimit strategjik, edukimit, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të politikave.

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të projektit "Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Shqipëri (JUFREX 2), pjesë e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022". Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

SQI

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën, diversitetin, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t`i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokumenti i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

Financuar nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet nga Këshilli i Evropës



RESPUBLICA